



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Financije, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi TM1-2022 (2015=100)

Maj, 2022

Prishtinë, 06.05.2022, Agjencia e Statistikave të Kosovës, përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, ka filluar të grumbullojë të dhëna për çmimet e prodhimeve bujqësore që nga nëntori i vitit 2003. Në fillim, numri i artikujve ishte i kufizuar. Me ndërrimin e vitit bazik nga viti 2003 në vitin bazik 2005, çmimet janë grumbulluar për 64 prodhime të ndryshme bujqësore. Kurse, me ndërrimin e vitit bazik 2005 në 2010, janë grumbulluar çmimet për 67 prodhime bujqësore. Aktualisht, me ndërrimin e vitit bazik nga 2010 në vitin bazik 2015, çmimet grumbullohen për 71 prodhime të ndryshme bujqësore. Qëllimi i indeksit të prodhimeve bujqësore është matja e lëvizjeve të çmimeve për prodhimet e shitura nga fermeri. Plani për të ardhmen është që të rritet numri i produkteve. Si plotësim i indeksit të prodhimeve është edhe indeksi i çmimeve të inpueteve.

Ky është publikimi i shtatëdhjetë (70) mbi indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe çmimeve mesatare absolute të prodhimeve bujqësore, i përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Në këtë publikim, indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore është paraqitur për disa prodhime kryesore bujqësore.

ASK-ja falënderon Agjencionin Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Kooperim (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK-ja, gjithashtu falënderon të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK për bashkëpunim, bashkëpunëtorët e tjerë (respondentët) e pikave-vendeve të grumbullimit të çmimeve, si: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale, tregtare etj.

Në veçanti, ASK-ja falënderon ekspertët suedezë të statistikave të çmimeve, z. Anders Grönvall dhe të tjerët, që në mënyrë të drejtpërdrejtë a indirekte ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb faqes infoask@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani - Drejtor i departamentit,
Violeta Arifi – Gashi - Shefe e divizionit,

Z.v. i Kryeshef Ekzekutiv, ASK
Ilir.T.Berisha

Lista e shkurtesave

- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇPB - Indeksi i Çmimeve të Produkteve Bujqësore
BE - Bashkësia Evropiane
SIDA - Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim
TM1 - Tremujori i parë

Simbolet

- - Të pa aplikueshme
‰ - Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

Përmbajtja

Faqe

Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM1 2015-2022 (2015=100)	5
Tab. 1: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM1 2015-2022 (2015=100)	5
Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore	6
Tab.2:Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, janar-mars 2022 (2015=100).....	6
Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore	7
Tab. 3: Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore janar-mars 2022	7
Shpjegime metodologjike.....	10
Pyetëtori.....	12

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore

Të dhënat e prezantuara në këtë publikim përfshijnë të dhëna për indeksin prej muajit janar deri në mars të vitit 2022 (2015=100) që mbulon periudhën 2015-2022. Për të bërë krahasime dhe për të vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për tremujorët e parë(TM1) të viteve 2015-2022 me vitin bazik 2015,(2015 =100)

ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazik të indeksit nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit.

Në këtë publikim janë grumbulluar çmimet e prodhimeve vendore bujqësore në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është bërë në: treg, ferma dhe vendet të tjera.

Prodhimet, që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale.


Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë.

Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Figura 1 prezanton indeksin e tremujorit të parë (TM1) 2015-2022 të çmimeve të prodhimeve bimore dhe blegtorale, gjithashtu prezanton totalin e prodhimeve bujqësore.

Në tremujorin e parë të vitit 2022 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për (15,33%) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për (25,62%) në tremujorin e parë të vitit 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Indeksi total i prodhimeve bujqësore ka rritje për (17,72%) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Fig 1: Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore,blegtoriale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM1 2015-2022, (2015=100)



Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM1 2015-2022 (2015=100)

Tab. 1: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM1 2015-2022(2015=100)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	TM1 2015	TM1 2016	TM1 2017	TM1 2018	TM1 2019	TM1 2020	TM1 2021	TM1 2022
010000	DRITHËRAT (përfshirë farërat)	103,9	100,1	95,9	78,7	109,7	112,5	92,9	149,5
011000	Grurë dhe spelt (spelt = Triticum aestivum spelta)	104,3	99,9	95,5	77,1	110,1	113,0	92,5	150,4
011100	Grurë i butë dhe speltë	104,3	99,9	95,5	77,1	110,1	113,0	92,5	150,4
012000	Thekërë dhe meslin (meslin = përzjerje gruri dhe thekëre, lloj drithi)	105,4	104,0	102,6	90,9	87,1	97,7	91,5	105,9
013000	Elb	99,7	101,3	97,3	96,4	89,8	97,6	79,5	95,4
013200	Elb për prodhimin e birrës	99,7	101,3	97,3	96,4	89,8	97,6	79,5	95,4
014000	Tërshër dhe perzjerje të drithërave verore	105,3	107,2	103,3	94,8	94,8	84,9	98,4	106,2
015000	Misër kokërr	96,7	102,8	102,8	106,7	106,7	107,7	102,9	146,1
030000	BIMË FORAGJERE	93,8	141,8	116,1	111,8	118,9	107,7	117,9	146,9
031000	Misër për ushqim kafshësh	97,3	103,4	97,6	92,0	92,3	94,6	97,6	135,5
032000	Kultura tuberoze për ushqim kafshësh (përfshirë panxharin foragjerë)	:	:	:	:	:	:	:	:
039000	Bimë tjera foragjere	93,7	142,7	116,5	112,3	119,5	108,0	118,4	147,2
040000	PERIME DHE PRODUKTE TJERA HORTIKULTURORE	103,8	97,6	97,7	97,9	103,1	102,0	104,8	112,6
041000	Perime të freskëta	103,8	97,6	97,7	97,9	103,1	102,0	104,8	112,6
041100	Lulelakër	:	:	:	:	:	:	:	:
041200	Domate	:	:	:	:	:	:	:	:
041900	Perime tjera të freskëta	103,8	97,6	97,7	97,9	103,1	102,0	104,8	112,6
042000	Bimë dhe lule	:	:	:	:	:	:	:	:
050000	PATATE (përfshirë farërat)	94,3	105,6	96,0	86,9	130,1	100,6	120,0	171,6
051000	Patate për konsum	94,3	105,6	96,0	86,9	130,1	100,6	120,0	171,6
060000	PEMË	103,4	99,5	105,6	124,9	100,4	116,1	114,2	105,6
061000	Pemë të freskëta pa i përfshirë agrumet dhe rrushin	103,4	99,5	105,6	124,9	100,4	116,1	114,2	105,6
061100	Mollë tryeze	94,3	90,3	101,0	121,6	91,2	114,3	115,5	103,2
061200	Dardhë tryeze	119,0	131,2	122,8	138,5	125,7	145,8	135,6	128,3
061300	Pjeshkë	:	:	:	:	:	:	:	:
061900	Pemë të freskëta arrë,lajthi,gështenjë dhe fruta të tharë	112,5	94,3	101,6	121,0	101,4	93,6	91,5	91,0
062000	Agrume	:	:	:	:	:	:	:	:
063000	Pemë tropikale	:	:	:	:	:	:	:	:
064000	Rrush	:	:	:	:	:	:	:	:
100000	PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)	99,5	107,3	100,5	96,8	113,9	105,0	110,5	138,8
101000	PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), pa i përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)	96,3	114,4	101,6	92,0	122,5	105,2	113,5	159,9
110000	BLEGTORIA	98,8	96,8	98,8	97,4	106,3	101,4	102,6	129,3
111000	Gjedhët	101,8	96,8	99,2	97,8	111,9	105,4	107,5	125,4
111100	Gjedhët pa i përfshirë viçat	102,4	97,7	100,2	99,8	114,5	107,0	105,8	123,8
111200	Viçat	100,6	95,0	96,9	93,7	106,3	102,1	111,3	128,8
112000	Derrat	97,9	96,2	95,7	93,7	103,4	96,2	99,0	138,2
113000	Njëthundrakët (Kuaj,Gomarë,Mushka)	:	:	:	:	:	:	:	:
114000	Dele dhe dhi	95,2	96,9	99,6	98,8	101,5	97,9	94,5	132,0
115000	Shpezët	96,5	98,0	100,2	97,4	98,2	102,7	109,9	123,0
115100	Pulat	96,5	98,0	100,2	97,4	98,2	102,7	109,9	123,0
115900	Shpezët tjera	96,5	98,0	100,2	97,4	98,2	102,7	109,9	123,0
119000	Kafshë tjera	:	:	:	:	:	:	:	:
120000	PRODHIMET BLEGTORIALE	102,8	100,9	106,2	104,9	106,2	111,9	107,6	119,8
121000	Qumësht	102,8	100,7	101,5	102,9	104,2	110,6	104,7	116,5
121100	Qumësht lope	102,8	100,7	101,5	102,9	104,2	110,6	104,7	116,5
121900	Lloje tjera qumshti	:	:	:	:	:	:	:	:
122000	Vezë	105,8	102,6	131,7	115,1	116,0	117,2	117,3	135,6
129000	Produkte tjera blegtorale	94,5	99,9	106,7	107,2	109,1	116,4	124,7	126,2
130000	BLEGTORIA DHE PRODHIMET BLEGTORIALE (110000+120000)	101,7	99,8	104,1	102,8	106,2	109,0	106,2	122,4
140000	GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)	101,2	101,5	103,3	101,5	107,9	108,1	107,1	126,1
141000	GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), pa përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)	100,9	101,9	103,8	101,3	108,5	108,4	107,2	127,7

Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore

Tab. 2: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, janar-mars 2022 (2015=100)

Kodi i artikullit	Grupet	Peshat		2022		
		%	1000 Euro	Jan	Shk	Mar
0 1	Drithërat	27	8.940	143,1	153,2	153,6
0 1.1	Grurë	26	8.455	143,9	154,2	154,2
0 1.3	Elb	0	48	91,1	95,4	99,7
0 1.5	Misër	1	364	139,1	145,9	155,8
0 1.9	Drithëra tjera	0	73	103,0	106,6	110,2
0 3	Bimët foragjere	36	11.643	145,3	146,6	149,8
0 3.1	Misër për ushq. kafshëve	1	425	131,1	136,0	142,1
0 3.9	Bimët tjera foragjere	34	11.218	145,8	147,1	150,0
0 3.9.1	Sanë	26	8.493	146,2	146,2	147,2
0 3.9.2	Kashtë	4	1.234	143,8	147,6	157,2
0 3.9.9	Bimët tjera foragjere ;tjera	5	1.491	145,2	151,5	160,5
0 4	Perimet	210	68.778	111,7	112,9	112,6
0 4.1	Perimet e freskëta	210	68.778	111,7	112,9	112,6
0 4.1.2	Domate	31	10.107	:	:	:
0 4.1.9	Perimet tjera të freskëta	179	58.671	111,7	112,9	112,6
0 4.1.9	Speca	105	34.293	:	:	:
0 4.1.9.1	Lakër	1	388	179,4	179,4	:
0 4.1.9.4	Tranguj	1	429	:	:	:
0 4.1.9.6	Qepë	8	2.569	119,2	122,4	119,2
0 4.1.9.7	Fasulja	49	16.071	111,8	111,8	111,8
0 4.1.9	Shalqi	2	550	:	:	:
0 4.1.9.9.9	Perimet tjera të freskëta: tjera	13	4.371	100,3	106,8	115,0
0 5	Patatet	62	20.348	177,6	177,6	177,6
0 6	Pemët	87	28.598	110,9	100,3	100,0
0 6.1	Pemët e freskëta	52	16.970	110,9	100,3	100,0
0 6.1.1	Molla	7	2.360	103,2	103,2	103,2
0 6.1.2	Dardha	6	1.963	128,3	:	:
0 6.1.9	Pemët tjera	39	12.646	90,6	93,0	88,8
0 6.1.9.2	Kumbulla	22	7.221	:	:	:
0 6.1.9.4	Frutat e thata,Gështenjë	3	846	90,6	88,8	88,8
0 6.1.9.9	Pemët tjera,të tjera	14	4.579	90,7	105,6	:
0 6.4.1	Rrushi	12	3.899	:	:	:
0 6.4.9	Rrush për verëra	24	7.729	:	:	:
10	Prodhimet bimore	423	138.307	126,1	125,3	125,3
11	Blegtoria	162	52.824	127,8	129,0	131,1
11.1	Mëzet dhe Mëshqerra	74	24.125	124,4	125,0	126,8
11.2	Derra	28	9.199	135,6	138,8	140,1
11.4	Dele	46	14.944	130,9	130,9	134,4
11.5	Pula	14	4.556	119,7	124,3	124,9
11,9	Kafshë - tjera	0	-	:	:	:
12	Prodhimet blegtorale	415	135.853	116,5	117,2	125,6
12.1	Qumësht	334	109.198	113,0	113,5	122,9
12.2	Vezë	62	20.112	133,5	135,6	137,6
12.9	Prodhimet tjera blegtorale	20	6.543	122,8	122,8	133,0
13	Blegtoria dhe prodhimet blegtorale	577	188.677	119,7	120,5	127,1
14	Totali i prodhimeve bujqësore	1000	326.984	122,4	122,5	126,4

Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore

Tab. 1: Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore janar- mars 2022

Kodi i artikullit	Prodhimet	Njësia	2022		
			Jan	Shk	Mar
01.1.	Gruri ¹	kg	0,28	0,30	0,30
01.3.	Elbi ²	kg	0,30	0,31	0,33
01.5.	Misri ³	kg	0,33	0,34	0,36
01.2.	Thekër ⁴	kg	0,36	0,37	0,37
01.4.	Tërshërë ⁵	kg	0,33	0,34	0,36
03.9.1	Sana ⁶	kg	0,21	0,21	0,21
03.9.2	Kashta ⁷	kg	0,11	0,11	0,12
03.9.9.	Jongja ⁸	kg	0,23	0,24	0,26
05.1.	Patate ⁹	kg	0,60	0,60	0,60
04.1.9.1	Lakëra ¹⁰	kg	0,41	0,41	
04.1.9.6	Qepa ¹¹	kg	0,53	0,54	0,53
04.1.9.9.9	Speca ¹²	kg	:	:	
04.1.9.3	Spinaqi ¹³	kg	:	:	
04.1.9.7	Fasulja ¹⁴	kg	3,00	3,00	3,00
04.1.2	Domatja ¹⁵	kg	:	:	
04.1.9.4	Tranguj ¹⁶	kg	:	:	
04.1.9.9.9.1	Shalqi ¹⁷	kg	:	:	
04.1.9.9.9.2	Presh ¹⁸	kg	0,91	0,93	0,90
04.1.9.9.9.3	Hudher ¹⁹	kg	3,71	3,64	3,26
06.1.1	Molla ²⁰	kg	0,50	0,50	0,50
06.1.2	Dardha ²¹	kg	1,26	:	
06.1.3	Gështënja ²²	kg	2,71	:	
06.1.9	Arra ²³	kg	2,50	2,53	2,53
06.1.4.1	Rrush ²⁴	kg	:	:	
11,1	Mëzet dhe meshqerra ²⁵	kg	2,76	2,77	2,80
11,2	Derra ²⁶	kg	3,04	3,11	3,14
11,4	Dele ²⁷	kg	3,23	3,23	3,31
11,5	Pula (Fshati) ²⁸	1 copë	12,79	13,29	13,29
11.5.1	Pula (ferme) ²⁹	1 copë	2,00	2,07	2,14
12,1	Qumësht ³⁰	1 lit	0,34	0,34	0,37
12,9	Mjalt ³¹	kg	12,00	12,00	13,00
12,2	Veze ³²	30 copë	2,98	3,03	3,07

¹ (.) Tregon se në këta muaj nuk grumbullojmë çmime të prodhimeve bujqësore për këto kultura bujqësore (Lakrë,Speca, Spinaqi, Domate,Tranguj, Shalqi, Molla, Dardha, Gështënjë, Rrush)

1– Gruri – prodhim vendor, 2 Elbi , 3 Misri – Hibrid 448, 4 Tthekër 5 Tershër, 6 Sana , 7 Kashtë gruri, 8 Jongjë, 9 Patate 10 Lakër- varieteti (Hibrid 4), 11 Qepë klasa e dytë e kualitetit, 12 Speci- Varieteti Sombork, 13 Spinaqi- varieteti Matador, klasa e dytë e kualitetit, 14 Fasulja klasa e dytë e kualitetit, 15 Domate- Varieteti Arleta, 16 Tranguj- Varieteti Cornishon, 17 Shalqi– prodhim vendor, 18 Presh prodhim vendor, 19 Hudhra prodhim vendor, 20 Molla varitet Idaret, 21 Dardha – varieteti autokton , 22 Gështenjë – prodhim vendor , 23 Arra, 24 Rrushi-varieteti hamburg, 25 Peshë e gjallë për 1kg, për mëzet dhe meshqerra të moshës 18-22 muaj, racë vendore, 26 Peshë e gjallë për 1kg, për derra të moshës 10-12 muaj, racë vendore, 27 Peshë e gjallë për 1kg, për dele racë vendore të moshës jo më të vjetër se 12 muaj, 28 Pula– vendore (të moshës rreth 18 javë Fshati), 29 Pula– vendore (të moshës rreth 18 javë të Fermes), 30 Qumësht lope –çmimi për 1litër me përmbajtje 3.2% yndyrë, 31 Mjaltë – prodhim vendor, 32 Veze çmimi për 30 copë, klasa e parë e kualitetit.

Fig. 2: Çmimi mesatar absolut për grurë dhe misër, janar- dhjetor 2021 dhe tremujori i parë 2022, (2015=100) Euro/kg




Fig. 3: Çmimi mesatar absolut për sanë, jonxhë dhe kashtë janar- dhjetor 2021 dhe tremujori i parë 2022, (2015=100) Euro/kg




Fig. 4: Çmimi mesatar absolut për patate, domate, speca dhe lakër janar- dhjetor 2021 dhe tremujori i parë 2022, (2015=100) Euro/kg





Fig. 5: Çmimi mesatar absolut për mëzet dhe mëshqerra, derra dhe dele si peshë e gjallë, janar- dhjetor 2021 dhe tremujori i parë 2022, (2015=100) Euro/kg



Shpjegime metodologjike

Çmimet dhe indekset e çmimit në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit Europian. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga Sida (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar nga nëntori i vitit 2003 dhe janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi. Disa çmime nuk janë në dispozicion për tërë periudhën. Çmimet grumbullohen për 71 prodhime dhe maten çmimet të cilat i marrin fermerët për pjesën e prodhimeve të tyre që janë shitur. Peshat për kalkulimin e indekseve janë kryesisht të bazuara në Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi të vitit 2015, që është vit bazë për indekset (2015=100). Duhet theksuar se peshat, në vlerë ose promil, reflektojnë vetëm pjesën e prodhimeve bujqësore në Kosovë që janë shitur jashtë ekonomive familjare bujqësore. Për disa prodhime vlera e prodhimit total mund të jetë shumë më e lartë se sa reflektohet në pesha.

Sipas standardeve të BE-së, indekset tremujor dhe vjetor supozohet të kalkulohet nga secili shtet anëtarë. Indekset e BE-së në këtë publikim ndjekin metodologjinë e BE-së. Për nevoja nacionale, kalkulohet edhe indeksi mujor. Ky indeks kalkulohet pak më ndryshe se indeksi tremujor. Shkurtimisht, indeksi mujor nuk i përdor peshat mujore në nivelin e agreguar (kur kalkulohet kodi 10, 13 dhe 14). Megjithatë për shumicën e grupeve të kulturave (kodi 01, 03, 04 dhe 06) peshat mujore janë përdorur brenda grupit për të kalkuluar peshat e agreguara të grupit. Në anën tjetër indeksi tremujor çdo kund ka peshë tremujore variabile. Për këtë arsye, indekset mujor dhe tremujor mund të kenë zhvillime me ndryshime të vogla nëse krahasohen. Sidoqoftë, indeksi vjetor i BE-së dhe indeksi vjetor i Kosovës janë plotësisht të njëjtë. Në të dyja rastet, indeksi është kalkuluar si indeks vjetor e peshuar me pesha mujore respektivisht tremujore.

Peshat totale, peshat tremujore dhe peshat mujore janë fikse gjatë periudhës bazë. Të gjitha reflektojnë situatën që ishte e pranishme në vitin 2015. Duke pasur pesha fikse, indeksi është garantuar vetëm për të matur lëvizjet e çmimeve, që është qëllimi i indeksit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faqja elektronike e Eurostat-it (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home>).

Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Llogaritja e indeksit elementar është bërë në përgjithësi sipas formulave në vijim duke shfrytëzuar çmimet mesatare aritmetike të papeshuara.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^o} \cdot 100$$

R_i – Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i

P – Çmimet e grumbulluara

i – Prodhimi i

j – Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin 1,2,...,n)

t – Muaji i vëzhguar

0 – Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është bërë duke shfrytëzuar formulat në vijim.

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0} \right)$$

I^t	Indeksi i agreguar për periudhën t
w_i^0	Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i
i	Prodhimi i
t	Muaji i vëzhguar
0	Muaji bazë

Pyetëtori

DEFINICIONI -Përcaktimi i cakt (artikujve- vareteteve)

Numri artikullit	i			Emri i artikullit	Sasia	Njësia
Grumbulluesi i çmimit				Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja		
Data						
Çmimi						
<p>Shënimet e anketuesve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim të çmimit - Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve - Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar (informacionet e vrojtmeve të dyfishta të çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit) 						

- **Adresa:** AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.